



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 10 Mars 2021

Nr: 132

VENDIM

**PËR KTHIMIN PËR KORRIGJIM TË DOKUMENTACIONIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR DEPUTET TË DEPOZITUAR NGA
KOALICIONI “ALEANCA BASHKIMI POPULLOR - EMIGRACIONI - ORA E
SHPRESËS DHE KONSERVATORËT” (ABEOK) PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN
TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, neni 67, neni 72 dhe neni 73, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe Udhëzimit nr.1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

V Ë R E J:

Koalicioni “Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Në bazë të neneve 67 e 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, koalicioni “Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët” ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemore për 12 zona zgjedhore.

Në bazë të nenit 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemore të kandidatëve për deputet të Koalicionit “Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët” dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur. Në përfundim të procesit të verifikimit paraprak u konstatuan mangësi dhe mospërmbushje të dokumentacionit si më poshtë:

1. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Berat**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke mos e plotësuar numrin e kërkuar me 3 kandidatë dhe me kriterin gjinor të përcaktuar në pikën 6 të po këtij neni;



2. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Dibër**, në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 1, z. Luan Jakimi, rezulton që në pikën 8 ka deklaruar të plotësuar me “JO”, por ka dhënë specifikime të dhënash;
3. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Dibër**, në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 5, z. Laim Tota, rezulton që pika 8, është e pa plotësuar;
4. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Durrës**, në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 2, zj. Anita Dervishi, rezulton që pikat 5 dhe 8, janë të pa plotësuar;
5. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Durrës**, në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 4, z. Ardit Gaci, rezulton që pikat 1, 2 dhe 8, janë të pa plotësuar;
6. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Durrës**, në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 7, z. Isli Mala, rezulton që pika 2 është pa plotësuar;
7. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Elbasan**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor duke mos e plotësuar numrin e kërkuar me 1 kandidat dhe me kriterin gjinor të përcaktuar në pikën 6 të po këtij neni;
8. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Elbasan**, jetëshkrimi (Model 07) i kandidatit për deputet me numër rendor 9, zj. Matilda Gjuzi rezulton i paplotësuar;
9. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Elbasan**, në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 2, zj. Enkeleda Latifi, rezulton që pika 5 është e pa plotësuar;
10. Në dokumentacionin e kandidimit për kandidatët e listës shumemërore **Qarku Elbasan**, konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 4, z. Shkëlzen Kreci;
11. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Elbasan**, në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 9, zj. Matilda Gjuzi, rezulton që në rubrikën “A”, nuk ka të plotësuar nr. ID;
12. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Elbasan**, në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 11,



- z. Alban Cani, rezulton që pika 8 është pa plotësuar;
13. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Elbasan**, në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve për deputet me numër rendor 12, zj. Enada Ciko dhe numër rendo 14. z. Besnik Hoxha, rezultojnë që në rubrikën “A”, nuk kanë të plotësuar numër ID;
 14. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Gjirokastrë**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor duke mos e plotësuar numrin e kërkuar me 2 kandidat;
 15. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Gjirokastrë**, në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 3, zj. Rudjana Shkreta, rezulton që rubrika II dhe pika 8 janë pa plotësuar;
 16. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Fier**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke mos e plotësuar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
 17. Në dokumentacionin e kandidimit për kandidatët e listës shumemërore **Qarku Fier**, konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 4. z. Shkëlqim Gjuzi, numër rendor 5. z. Bardhyl Harizi, numër rendor 6. zj. Liri Shehi, numër rendor 7. z. Vladimir Ruci, numër rendor 8. z. Niko Suli, numër rendor 9. z. Roland Llato, numër rendor 10. zj. Alketa Korro, numër rendor 11. z. Lirim Pole, numër rendor 12. z. Aleks Bezhani, numër rendor 13. z. Marjo Cela, numër rendor 14. zj. Blerona Qori dhe numër rendor 15. zj. Shqipe Narta;
 18. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Kukës**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkalluar numrin e kërkuar me 1 kandidat;
 19. Në dokumentacionin e kandidimit për kandidatët e listës shumemërore **Qarku Korçë**, konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 6. zj. Luljeta Përbasha, numër rendor 10. zj. Shadie Gjuzi dhe numër rendor 11. z. Saimir Arapi;
 20. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Korçë**, rezulton që kandidati për deputet me numër rendor 7. z. Arjan Avdoli, nuk ka të depozituar faqën nr. 5. të formularit të vetëdeklarimit;
 21. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Korçë**, rezulton që kandidati për deputet me numër rendor 9. z. Spiro Josifi, nuk ka të depozituar faqën nr. 4. të formularit të vetëdeklarimit;



22. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Korçë**, në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 12. z. Andreas Metushi, rezulton që nuk ka nënshkruar faqen nr. 4 dhe 5;
23. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Lezhë**, në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 8. zj. Ada Gjeloshaj, rezulton që ka plotësuar me “JO” pikën 8 por ka specifikuar të dhëna;
24. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Tiranë**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkaluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë dhe me kriterin gjinor të përcaktuar në pikën 6 të po këtij neni;
25. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Tiranë**, në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 9, z. Eraldo Murati, rezulton në rubrikën “A” nuk ka plotësuar nr. ID;
26. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Tiranë**, në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 36, z. Hasan Muha, rezulton që pika 8 është e pa plotësuar;
27. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Tiranë**, në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 38, zj. Adela Gjuzi, rezulton në rubrikën “A” nuk ka plotësuar nr. ID;
28. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Vlorë**, nuk është në përputhje me kriterin gjinor të përcaktuar në pikën 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor;
29. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Vlorë**, në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 6, z. Elisaveta Beqiraj, rezulton në rubrikën “A” nuk ka plotësuar nr. ID;
30. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Vlorë**, në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 8, z. Tasim Mehmeti, rezulton që ka plotësuar më “JO” pikën 8 por ka specifikuar të dhëna;
31. Në dokumentacionin e kandidimit për kandidatët e listës shumemërore **Qarku Vlorë**, konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 9. zj. Joana Karajani, numër rendor 10. z. Jetnor Haruni dhe numër rendor 12. z. Ylli Zagradi.



Në bazë të nenit 73 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dokumentacioni i depozituar kthehet për korrigjim, subjektit zgjedhor, Koalicioni “Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72 dhe 73, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

V E N D O S :

1. Kthimin për korrigjim, sipas gjetjeve të renditura më sipër, të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumëmbrore të kandidatëve për deputet, të Koalicioni “Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët”, (ABEOK) për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
2. Dokumentacioni i korrigjuar të depozitohet brenda datës 16.03.2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

